

VENDIM
Nr.586, datë 10.9.2004

**PËR MIRATIMIN E LISTAVE TË INVENTARËVE TË PRONAVE TË PALUAJTSHME
SHTETËRORE, TË CILAT U KALOJNË NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI SHOQËRIVE
ANONIME DHE NDËRMARRJEVE TË SISTEMIT TË TRANSPORTIT DETAR DHE AJROR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 8, pika 3, e 13 të ligjit nr.8743, datë 22.2.2001 "Për pronat e paluajtshme të shtetit", me propozimin e Ministrit të Pushtetit Vendor dhe të Decentralizimit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi "Autoritetit Portual, Durrës" sh.a.
Lista 1 që i bashkëlidhet këtij vendimi, përbëhet nga 4 (katër) fletë.
 2. Miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi "Portit Detar, Vlorë" sh.a.
Lista 2 që i bashkëlidhet këtij vendimi, përbëhet nga 14 (katërmëdhjetë) fletë.
 3. Miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi "Portit Detar, Shëngjin" sh.a.
Lista 3 që i bashkëlidhet këtij vendimi, përbëhet nga 2 (dy) fletë.
 4. Miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi "Portit Detar, Sarandë" sh.a.
Lista 4 që i bashkëlidhet këtij vendimi, përbëhet nga 3 (tri) fletë.
 5. Miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi ndërmarrjes "Kapiteneria e Përgjithshme e Porteve, Durrës".
Lista 5 që i bashkëlidhet këtij vendimi, përbëhet nga 2 (dy) fletë.
 6. Miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi "Ndërmarrjes së Kontrollit të Shërbimit të Mjeteve Ujore, Vau i Dejës".
Lista 6 që i bashkëlidhet këtij vendimi, përbëhet nga 4 (katër) fletë.
 7. Miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi "Regjistrin Detar Shqiptar, Durrës" sh.a.
Lista 7 që i bashkëlidhet këtij vendimi, përbëhet nga 1 (një) fletë.
 8. Miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi ndërmarrjes "Drejtoria e Përgjithshme e Aviacionit Civil, Tiranë".
Lista 8 që i bashkëlidhet këtij vendimi, përbëhet nga 1 (një) fletë.
 9. Miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi "Aeroportit "Nënë Tereza", Tiranë" sh.a.
Lista 9 që i bashkëlidhet këtij vendimi, përbëhet nga 4 (katër) fletë.
 10. Miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi "Agjencisë Nacionale të Trafikut Ajror, Tiranë" sh.a.
Lista 10 që i bashkëlidhet këtij vendimi, përbëhet nga 5 (pesë) fletë.
- Ngarkohen Ministri i Pushtetit Vendor dhe i Decentralizimit, Ministri i Transportit dhe i Telekomunikacionit, Ministri i Ekonomisë dhe kryeregjistruesi i Zyrës Qendrore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano